

GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS

P.No. 40/2010

13 Prill 2011

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it, Caroline Charpentier, si gjyqtare kryesuese, ai dhe gjyqtarët e EULEX-it, Nikolay Entchev dhe Dariusz Sielicki, si anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it, Anu Juho, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër:

MEXHIT BEQIRIT, të akuzuar me Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147, pika 9) në lidhje me pikën 40, me Mbajtje, Kontroll dhe Posedim të pa-autorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) dhe Kanosje në kundërshtim të Nenit 161, Paragrafi (3) në lidhje me Paragrafin (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së);

Pas Mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, të hapura për publikun, më datë 11, 12, dhe 13 Prill 2011, në praninë e të akuzuarit Mexhit Beqiri, të Avokatit të tij Mbrojtës, Muharrem Ramadani, Prokurorit Publik të EULEX-it, Antonio Patsore, Palës së Dëmtuar Islam Zeka dhe Përfaqësuesit të tij të Autorizuar, Avokatit Rexhep Kaçaniku;


Pas shqyrtimit nga ana e Trupit Gjykues dhe votimit të mbajtur më datë 13 Prill 2011, në pajtim me Nenin 392, paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) shpallë më 13 Prill 2011, publikisht dhe në prani të të Akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it, Antonio Pastore, Palës së Dëmtuar dhe Përfaqësuesit të tij të Autorizuar, si në vijim, këtë

AKTGJYKIM

MEXHIT BEQIRI, i lindur më 15.07.1952, në fshatin Tërstenë, Komuna e Mitrovicës, me banim në fshatin Sllatinë, komuna e Vushtrrisë, emrii babait Ragip, emri i nënës Shehide, mbiemri i vajzërisë së nënës Hasani, të kryer e ka shkollën e lartë, i pa-punë, pa të ardhura, në paraburgim që nga 30 Maji 2010;

është shpallur

FAJTOR



A – Sepse më datë 27 Maj 2010 rreth orës 9.30 në fshatin Sllatin, Komuna e Vushtrrisë, ka privura nga jeta Sylejman Zekën, në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme. Të njëjtën ditë, i ndjeri Sylejman Zeka ngiste makinën e tij të tipit Mercedes 190, me numër të regjistrimit 289-KS-353, me djalin e tij dyvjeç Albin Zeka. Makina e tij ngeli në baltë në vendin e quajtur “*fushat e serbëve tek burimi i ujit*”. Ai telefonoi bashkëfshatarine tij Musa Beqiri dhe kërkoi ndihmë. Musa Beqiri shkoi atje me makinën e tij BMW me numër të regjistrimit 311-KS-236 dhe e ndihmoi atë të dalë nga balta. Musa Beqiri e drejtoi makinën e tij për një distancë 50 metra, kurse viktima e drejtonte makinën e tij pas Musës. Njëri pas tjetrit, në një distancë 50 metra, ata ngisnin makinën pranë portës së të Akuzuarit Mexhit Beqiri i cili qëndronte jashtë, në rrugë. Posa Mexhit Beqiri e pa viktimën në makinën e tij, u ngrit dhe qëlloi në drejtim të viktimit disa herë dhe e qëlloi në pjesë të ndryshme të trupit të tij me revolen e tij “CZ PARA M70” të kalibrit 9 mm, numër serik 40074. Viktima Sylejman Zeka ia arriti të dalë nga makina e tij dhe të vrapojë në drejtim të makinës së Musës të tipit BMW. Ai hyri në makinën BMW dhe u ul në ulësen e pasagjerit. Nëndërkohë, i akuzuari Mexhit Beqiri e ndiqte pas me revole, duke iu afruar makinës BMW dhe duke përdorur revolen e tij. Ai qëlloi përsëri shumë herë në drejtim të viktimit deri sa nuk shpenzoi tërësisht karrikatoren. Ai rimbushi me plumba dhe qëlloi mbi viktimën përsëri dhe duke vepruar kështu i shkaktoi plagë të rënda viktimit, Sylejman Zeka, i cili vdiq posa arriti në spital.

Duke vepruar në këtë mënyrë, i akuzuari Mexhit Beqiri ka kryer vepër penale dhe mban përgjegjësi penale për veprën penale të **Vrasjes së Rëndë**, sipas Nenit 147 paragrafit (5) të KPK-së (Pika I);

është shpallur


FAJTOR

B – sepse deri rreth orës 10.00, më datë 27 Maj 2010, në fshatin Sllatinë të komunës së Vushtrrisë ka qenë në posedim dhe pronësi pa leje (Liçensë) valide të mbaj një armë të autorizuar, revole të tipit “Zastava”, të kalibrit 9 mm, numër serik 40074.

Duke vepruar kështu, i akuzuari Mexhit Beqiri ka kryer vepër penale dhe mban përgjegjësi penale për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së sipas Nenit 328, paragrafi (2) të KPK-së (Pika II);

është shpallur

FAJTOR



- **Sepse** më 27 Maj 2010 në Vushtrri, ka vringëlluar në drejtim të viktimës, Musa Beqiri, djalë i vëllaut të tij, gjer sa ky i dyti pwrpiqej ta ndalte, armën “Zastava” të kalibrit 9 mm me numër serik 40074, në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese duke thënë; “*Largohu, ose të vras edhe ty*”,

Duke vepruar kështu, i akuzuari Mexhit Beqiri ka kryer veprë penale dhe mban përgjegjësi penale të veprës penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së

PRANDAJ, i akuzuari Mexhit Beqiri

DËNOHET

- A. Me gajshtëmbëdhjetë /16/ vjet burgim për veprën penale të **Vrasjes së Rëndë**, sipas Nenit 147, pika 5 e KPK-së (Pika I);
- B. Me tre /3/ vjet burgim për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së, (Pika II);
- C. Me dy /2/ vjet burgim për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së (Pika III).


Dënimi unik është 18 vjet burgim, sipas Nenit 71 paragrafit (1) dhe paragrafit (2) pikës 2 të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim që nga data 30.05.2010 do të llogaritet në pajtim të Nenit 73 paragrafit (1) të KPK-së.

Arma – revolva ZASTAVA, e kalibrit 9 mm, me numër serik 40074, konfiskohet sipas Nenit 60 paragrafit (1) dhe Nenit 328 paragrafit (5) të KPK-së.

Në pajtim me Nenin 112 (2) të KPK-së, meqë të dhënat e mbledhura në procedurën penale nuk ofrojnë bazë kredibile as për dëmshpërblim të plotë e as të pjesërishtëm, Gjykata e udhëzon Palën e Dëmtuar që kërkesën e tërë për dëmshpërblim ta ushtrojë në gjykatën për çështje civile gjyqësore.

I akuzuari Mexhit Beqiri do të kompensojë pjesën e tij të procedurës penale në pajtim me Nenin 102, paragrafi (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga ana e gjyqit kur të dhënat në fjalë të sigurohen në pajtim të Nenit 100, paragrafit (2) të KPPK-së.



ARSYETIM

A. Sfondi Procedural

Prokurori Publik i Qarkut të Mitrovicës në aktakuzën PP. Nr. 78/2010 të parashtruar më 19 Tetor 2010, ngarkonte MEXHIT BEQIRIN ME Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147, Pika 9) në lidhje me Pikën 4) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), me Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafit (2) të KPK-së, si dhe me Kanosje në kundërshtim të Nenit 161, Paragrafit (3) në lidhje me Paragrafin (2) të KPK-së, në lidhje me Pikën 1 dhe 2.


Aktakuza u konfirmua më 29 Nëntor 2010. Më 02 Dhjetor 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it e caktoi çështjen tek Gjyqtarët e EULEX-it në bazë të Nenit 3.3 të Ligjit mbi Kompetencat, Për Përzgjedhjen dhe caktimin e Lëndës tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it.

Seancat e shqyrtimit kryesor janë mbajtur më datë 11, 12, 13 Prill 2011. Fjalimet përmbyllëse janë dhënë nga Prokurori EULEX-it, Antonio Pastore, Avokati Mbrojtës, Muharrem Ramadani dhe i pandehuri Mexhit Beqiri më datë 13 Prill 2011. Aktgjykimi u dha me gojë po atë ditë.

B. Kompetencat e Gjykatës

Sipas Nenit 23, pikës 1 i) të KPPK-së. Gjykatat e qarkut janë kometente të dëgjojnë lëndën që përfshinë akuza për të cilën ligji parasheh dënimin deri në 5 vjet. Në pajtim me Nenin 27 paragrafi (1) i KPPK-së, jurisdikcioni teritorial është i duhur me gjykatën në qarkun ku vepra e pretenduar është kryer.

I akuzuari është ngarkuar me veprën penale të Vrasjes së Rëndë sipas Nenit 147, pika 9) në lidhje me pikën 4) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) që parasheh shqiptimin e dënimit të së paku 10 vjet burgim; Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK-së që parasheh shqiptimin e dënimit me gjobë deri në 7500 Euro ose burgim nga një deri në tetë vjet dhe sa për Kanosje në kundërshtim të Nenit 161, paragrafi (3) në lidhje me Paragrafin (2) të KPK-së në lidhje me Pikën 1 dhe 2 parasheh shqiptimine dënimit me gjobë ose burgim deri në 2 vjet.



Aktakuza pretendonte se i akuzuari ka kryer veprë penale në fshatin Sllatinë të komunës së Vushtrrisë që shtrihet brenda Qarkut të Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës është organ gjyqësor kompetent që të merret me këtë procedurë penale.

C. Kualifikimi Ligjor – Ligji i aplikuar

Veprat penale janë kryer më 27 Maj 2010. Në kohë, Kodi Penal i Kosovës që kishte hyrë në fuqi më 6 Janar 2009 ishte ligj i aplikueshëm. Në pajtim me Nenin 2 Paragrafi (1) dhe (2) i KPK-së, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të aplikohet kundër kryesit po qe se nuk ka një ligj të ri më të favorshëm për të akuzuarin.


D. Provat

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor, janë dëgjuar dëshmitarët si në vijim:

- (1) Islam Zeka, pala e dëmtuar, 11 Prill 2011
- (2) Teuta Beqiri, dëshmitare e Prokurorisë, 1 Prill 2011
- (3) Musa Beqiri, dëshmitar i Prokurorisë, 1 Prill 2011
- (4) Doktor Fahri Drevinja, dëshmitar ekspert, 12 Prill 2011
- (5) Emine Dushnica, dëshmitare e mbrojtjes, 12 Prill 2011
- (6) Selim Kurti, dëshmitar i mbrojtjes, 12 Prill 2011

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor, janë lexuar dhe konstatuar si prova dokumentet si në vijim:

- (1) Raporti i Ekzaminimit Forensik (balistik) i datës 06/07/2010 (faqe 66 – 74)
- (2) Raporti Mjekësor i datës 27/05/2010 (faqe 76-77)
- (3) Raporti i autopsisëme fotoalbum të bashkangjitur (faqe 78 – 118)
- (4) Raporti i Forensikës (Mjekësisë Ligjore) i datës 28/05/2010 (faqe 119-121)
- (5) Raporti Fillestar i Incidentit (faqe 153 -158)
- (6) Raporti i Zyrtarëve (faqe 159 – 173)
- (7) Raporti i Forensikës (Lista e provave) (faqe 174 – 184)
- (8) Skica e vendit të krimit si dhe e bashkangjitur, tabela e matjeve (faqe 187 – 191)
- (9) Raporti Forensikës (Lista e provave) me foto-albumin e bashkangjitur (faqe 192 0 204);
- (10) Raporti plotësues i Policisë (faqe 205 – 208)
- (11) Raporti i zyrtarëve i nënshkruar nga Aziz Aliu (faqe 209 0 210)
- (12) Raporti i policisë i datës 30/05/2010 (faqe 228 -229)
- (13) Vërtetimi mbi gjërat e konfiskuara (faqe 230 -231)



- (14)Foto albumi mbi vendin e ngjarjes (faqe 26- - 325)
- (15)Raporti i hetimeve të Vendit të Ngjarjes (faqe 336 – 341)
- (16)Raporti Psikiatrik i datës 18/03/2011 (pa numër në dosjen e çështjes tek Prokurori)

Më 12 Prill 2011, dëshmitari ekspert, Doktor Fahri Drevinja ka dhënë detaje lidhur me personalitetin e të akuzuarit që është diagnostifikuar si person me karakterisitika të çrregullimit të personalitetit të tipit asocial të koduar si F60.2 DSM IV. Dëshmitari ekspert qendroi pranë konkludimit të raportit mjeksor të datës 01.Mars 2011, duke deklaruar se na bazë të karaktersitikave të personalitetit të të akuzuarit, karakteri i veprës penale e poashtu edhe dinamika e veprës penale është se “ *përgjegjësia e tij është e zvogluar por jo deri në nivelin qenësor*”.

Gjatë seancës së shqyrtimit, më datë 12 Prill 2011, i akuzuari Mexhit Beqiri dha dëshmi dhe u përgjigj në pyetjet e shtruara.


E. Kryerja e krimit dhe përgjegjësia penale

1. Gjetjet faktike

Me prezetimin e provave gajtë rrjedhës së shqyrtimit kryesor, Gjyqi i konsideron këto fakte si të dëshmuara, si në vijim:

Më datë 30 Maj 2010 rreth orës 9.30 në fshatin Sllatinë të komunës së Vushtrrisë, Sylejman Zeka, i cili ishte me dajlin e tij dy vjeç, Albin Zeka, ngeli në baltë me makinën e tij të tipit Mercedes 190, me targa 289-KS-353. Ai e thirri Musa Beqirin, nja fqj, që ta ndihmojë për të nxjerrë makinën. Fqiu i tij errdhi ta ndihmojë. Pas këtij intervenimi të bërë, Musa Beqiri dhe Sylejman Zeka drejtuan makinat e tyre njëri pas tjetrit në një distancë prej 15 deri në 20 metra. Ata të dy drejtuan makinat pranë portës së Mexhit Beqirit, meqë nuk kishte rugë alternative. I akuzuari qëndronte ulur jashtë shtëpisë së tij.

Islam Zeka, babai i viktimës, ishte në këmbë aty afër, duke u përkujdesur për lopët në vendin e ashtuquajtur “*fushat e serbëve*”. Të shtënat u shkrepën në drejtim të makinës së Sylejman Zekës. Makina u ndal përballë portës së Mexhit Beqirit. Pasi dëgjoji të shtënat, Islam Zeka vrapoi në drejtim të makinës së birit të tij të merr nipin e tij, i cili ishte ulur në ulësen e pasagjerit. Një zënkë lindi mes Musa Beqirit dhe Mexhit Beqirit. Islam Zeka dhe Musa Beqiri, të dy ishin dëshmitarë se Mexhit Beqiri shkrepri disa herë në Sylejman Zekën gjersa viktimë e ndjerë ishte në përpjekje të arrijë ulësen e pasagjerit tek Musa Beqiri që ishte ndalur 15 metra larg.



Deklaratat e qëndrueshme dhe të pandryshuaratë dëshmitarëve okular të pranishëm në vendin e krimit, pala e dëmtuar Islam Zeka dhe Musa Beqiri, vërtetojnë këto fakte. Gjatë shqyrtimit kryesor, Islam Zeka dhe Musa Beqiri përsëritën deklaratat e tyre të mëparshme të dhëna gjatë fazës së hetimeve.

Në dëgjimin në polici më 7 Qershor 2010, Islam Zeka tregoi, *“Kur biri im hyri në makinën e Musës, Mexhiti shkoi aty dhe qëlloi mbi atë përsëri”*.


Kjo deklaratë është ngjajshme me atë të dhënë në polici më 27 Maj 2010 nga Musa Beqiri *“Dola nga makina dhe pashë Mexhitin duke qëlluar në drejtim të Sylës. Pastaj Sylja doli nga makina e tij duke mbajtur kokën ulur arrdhi tek makina ime dhe u ul në ulësen e parme të pasagjerit”*.

I akuzuari u përcaktua të mbetet në heshtje gjatë fazës së hetimeve (raporti mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit më 30 Maj 2010) dhe u deklarua si i pafajshëm gjatë konfirmimit të aktakuzës në seancën e 29 Nëntorit 2010. Sidoqoftë, nga hapja e sancës së shqyrtimit kryesor më 10 Prill 2011 Mexhit Beqiri pranoi se *“e kam kryer vrasjen pahiri dhe pa dashje”* deri në marrjen kryesore në pyetje më 12 Prill 2011 ku ai përshkroi se si qëlloi Sylejman Zekën *“E kapa në shpatull, e nxorra revolen dhe e përdora”*. Palët kontestojnë vetëm arsyet e të shtënave. Ai shpjegoi veprimet e tija gjatë shqyrtimit kryesor me faktin se viktima e kishte provokuar dhe kërcënuar gjer sa drejtonte makinën andej pari, se e kishte revolen e tij dhe doli nga makina që ta fyej *“ai e kishte revolen me vete, posa doli nga makina, më tha, ku je nanën ta bofsha kështu e ashtu”*. Pretendimet e Mexhitit se viktima kishte revole me vete ditën kritike nuk është vërtetuar me elemente brenda dosjes së lëndës ose gjatë shqyrtimit kryesor. Nuk është gjetur revole në vendin e krimit e as te viktima. Mexhit Beqiri pastaj shpjegoi serinë e dytë të të shtënave *“E ula brenda makinës, njëra këmbë i mbeti jashtë, e pashë që mundohej dhe e qëllova edhe me një të shtënë që ta përfundojë”*

Më 11 Prill 2011 në shqyrtimin kryesor, Teuta Beqiri tregoi se si e alarmuar nga të shtënat, vrapoi jashtë shtëpisë. Kur arriti tek makina e kushëririt të saj, i ndihmoi që ta ngrehë Sylejman Zekën e plagosur rëndë në makinën e Musës dhe pastaj e thirri emergjencën. Deklarata e Musa Beqirit më 25 Maj 2010 e konfirmoi deklaratën e saj.

Tani më Mexhit Beqiri ishte zhdukur nga vendi i krimit.

Pas të shtënave, Musa Beqiri e dërgoi Sylejman Zekën në spital të Vushtrrisë së bashku me babain e tij Faik Beqiri dhe Teuta Beqirin. Sylejman Zeka vdiq disa minuta pas arritjes në spital, Raporti i autopsisë i datës 28 Maj 2010 përfundon se vdekja rezultoi nga *“plagët nga të shtëna të shumëfishta”*.



Arsyet e kontestit në mes të Mexhit Beqirit dhe Syejman Zekës ishte e pamundur tëkonstatohen gjatë shqyrtimit kryesor. Dy arsye u përmendën megjithatë. E para është lidhur me një kontest të gjatë në mes Mexhit Beqirit dhe fqinjëve të tij, familjes Zeka. Kjo është lidhur me blerjen e një pasurie të Mexhit Beqirit nga ana e familjes Zeka. Këto fakte janë përmend gjatë shqyrtimit kryesor nga ana e dy dëshmitarëve të mbrojtjes, Emine Dushnica, bashkëshorte e Mexhitit për 12 vjet, si dhe Selim Kurti, blerës potencial i shtëpisë së Mexhit Beqirit. Arsye e dytë e përmendur janë faktet e vjetra që datojnë nga viti 2003 me çrast Mexhit Beqiri e fajëson Sylejman Zekën se e ka djegur oborrin e shtëpisë së tij (raporti policor i rastit me numër 2003 BD 1992). Agjë nuk rezultoi nga hetimet e policisë.

2. Lidhur me Akuzën e Vrasjes së Rëndë sipas Nenit 147, pika 9) në lidhje me Pikën 4) të Kodit Penal të Kosovës (KPK)


Që nga fillimi i shqyrtimit kryesor, ku i akuzuari është pyetur lidhur me deklarinime të tij të fajësisë gjer në dhënjen e dëhmisë së tij më 13 Prill 2011, Mexhit Beqiri pa ndryshim pranoi se e ka kryer vrasjen e Sylejman Zekës më 27 Maj 2010. Sidoqoftë, ai nuk e pranoi fajësinë duke e marr parasysh se akuzat kundër tij ishin gabim dhe se ai e vrau viktimën "pahiri dhe pa dashje".

Të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve gjatë hetimeve dhe shrytimit kryesor mbështesin deklaratën e Mexhit Beqirit në fjalë se ai qëlloi disa herë, një seri e shtënave gjer sa viktima ishte në makinën e tij, kurse seria e dytë e të shtënave kur makina ishte në makinën e Musa Beqirit ditën kritike.

Raporti i hetimit të vendit të krimit të datës 28 Maj 2010 përmend të gjitha dëshmitë e gjetura në vendin e krimit: njollat e gjakut në trotuarin afër makinës së makinës dhe në ulësen e prapme të pasagjerit në makinën e viktimës, 5 gëzhoja të kalibrit 9 mm që janë gjetur në lokacionin e incidentit dhe një gëzhojë e zbrazët (9mm) që është gjetur brenda makinës së viktimës, makinës së Sylejman Zekës e cila është dëmtuar nga projektilet (numër i regjistrimit 289-KS-353).

Më 2 qershor 2010 raporti i zyrtarit të policisë Aziz Aliu tregon se Mexhit Beqiri errdh tek ai të dorëzohet dhe ia dha revolën e vete Zastava 9 mm me numër serik 40074 me karrikatore me 8 plumba të pashkrepura të kalibrit 9 mm (vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve të datës 30 Maj 2010).

Nga raporti mbi armën të datës 06 Korrik 2010 konkludon se pesë gëzhojat e zbrazëta të



kalibrit 9X19 mm që janë gjetur në vendin e krimit janë shkrepur nga revolva Crvena Zastava "PARA" M70 të kalirit 9X19 mm me numër serik 40074 që është konfiskuar dhe i takonte Mexhit Beqirit. Konkludim i njëjtë vlenë edhe për 2 pjesë plumbash të gëzhojës me kalibër 9X19 mm që janë gjetur në trupin e viktimës.

Raporti i autopsisë së Sylejman Zekës të datës 28 Maj 2010 tregon se "*viktima kishte 14 katërmbëdhjetë lëndime trupore ku 13 nga ato ishin vrima që dyshohet se janë shkaktuar me armë zjarri, si dhe një gërvishje në shpindë. Në trupin e tij janë gjetur dy projektile*". Dy projektilet (kalibër 9X19mm) përputhen me kalibrin e gëzhojave të zbrazëta që janë gjetur afër makinës së viktimës dhe me plumbat e gjetur në armën e konfiskuar. Poashtu, një numër i vrimave (14) në trupin e viktimës përputhen me numrin e gëzhojave të zbrazëta që janë gjetur në vendin e krimit (5) dhe me dy projektile që janë gjetur në trupin e viktimës. Raporti i mjekut i datës 10 qershor 2010 jep të gjitha detajet e plagëve dhe konkludon duke dëshmuar se shkak i vdekjes është "*plagët e të shtënave të shumëfishta*".


Për shkak të gjitha provat e sipërme, Gjyqi konsideron se Mexhit Beqiri është fajtor për vrasje të rëndë.

Në pajtim të Nenit 386, paragrafit 2 të KPPK-së, Gjyqi i detyrohet vetëm përshkrimin faktik të veprës së të akuzuarit sipas aktakuzës dhe më vonë me konstatimin e provave të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor. Gjyqi nuk i detyrohet kërkesës së Prokurorit Publik sa i përket kualifikimit ligjor të veprës, as të inkorporuar në aktakuzë ose të prezantuar gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor.

Në rastin aktual, Gjyqi është i mendimit se kushtet për akuzë, ashtu siç është ngarkuar në aktakuzë, vrasje e rëndë sipas Nenit 147 paragrafit 4 dhe 9 nuk janë plotësuar meqë **qëllimi** i rrezikimit të jetës së një ose më shumë personave që parashihet me paragrafin 4 nuk është konstatuar e as hakmarrja apo bazat e motivit për vrasje.

Përkundrazi, Gjyqi e mbështetë idenë e vrasjes së rëndë sipas Nenit 147, Paragrafit 5 meqë i pandehuri e ka pranuar vrasjen, ishte i pamëshirmshëm dhe i dhunshëm për shkak të *modus operandi*, me një fjalë fakti se i pandehuri ka qëlluar në viktimën gjër sa ai ishte në makinë, e ndoqi viktimën deri tek makina tjetër kur përpiquej të ikte nga të shtënata dhe vazhdoi të qëllonte mbi atë, nga një distancë e afërt kur viktimia arriti tek makina e fqit të tij.

3. Mbi akuzën e Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa-autorizuar të armëve sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së



I pandehuri e pranoi pas leximit të Aktakuzës se ishte në posedim të një arme duke thënë se ai *“ishte i detyruar të mbajë një armë sepse ishte i kërcënuar”*. Pranimi i fajësisë është mbështetur edhe me elemente në dosjen e çështjes dhe me dëshmitë e dëshmitarëve.

Prandaj Gjyqi e shpall Mexhit Beqirin fajtor për Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të armëve sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së.

4. Mbi me akuzën e Kanosjes në kundërshtim të Nenit 161, paragrafi (3) në lidhje me Paragrafin (2) të KPK-së, në lidhje me pikat 1 dhe 2

Është fakt i padiskutueshëm se posa Mexhit Beqiri filloi të shtie mbi Sylejman Zekën, Musa Beqiri doli nga makina e tij dhe bëri përpjekje të bindë axhën e tij, i cili mbante revolën, të ndëpresë të shtie mbi atë.

Ky konstatim faktik mbëhstetet me deklaratat e të gjithë dëshmitarëve e poashtu edhe nga vet i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor.


Islam Zeka e konfirmoi në deklaratën e tij dhe në shqyrtimin kryesor se ai e pa Mexhit Beqirin duke e shtyrë nipin e tij i cili errdh t'i ndihmojë të birit të vet dhe *“përpiqej të ndalte Mexhitin”* (Deklarata e Islam Zekës me datë 07 Qershor 2010).

Musa Beqiri i tha policisë (deklarata e dëshmitarit më datë 27 Maj 2010) *“Mexhiti errdh duke e ndjekë Sylën. Unë u përpjeka ta ndali Mexhitin, por Mexhiti më tha: largohu ose të vras edhe ty dhe pastaj më shtyu dhe nuk mund ta ndalja”*.

Mexhit Beqiri nuk e pranoi fajin mbi akuzën e kanosjes kundër Musa Beqirit. Sidoqoftë gjatë shqyrtimit kryesor duke dhënë deklaratë ai tha: *“Musa Beqiri e ndali makinën e tij dhe tha”Të lutem axhë, mos e bo këtë punë”, unë i thash “largohu ose të vras edhe ty”. Ai e përsëriti deklaratën e tij më vonë gjatë dëshmisë së tij ”i thash, hiqmu syve ose të vras edhe ty. Isha i frikësura se do ta qëlloja me atë rast kur e vrisja tjetrin sepse unë e doja Musa Beqirin”*.

Është e pakontestueshme se Mexhit Beqiri e mbante armën e tij kur iu drejtua nipit të tij dhe kur tha, *“largomu syve ose të vras edhe ty”*.

Prandaj, duke e marr parasysh deklaratën e qëndrueshme të dëshmitarit dhe deklaratën e të akuzuarit lidhur me këtë pikë, Gjyqi e konsideron se Mexhit Beqiri është fajtor meqë është konstatuar se Mexhit Beqiri e ka kërcënuar nipin e tij gjer sa vringëllonte armën e tij.



Gjyqi e pranon kërkesën e rikualifikimit të bërë nga ana e Prokurorit nga Kanosja të përdorë armën, (Kanosje në kundërshtim të Nenit 161, Paragrafi (3) në lidhje me Paragrafin (2) të KPK-së) në mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së meqë elementi i zhvilluar në Gjyq ekonfirmoi këtë kualifikim.

5. Parashtrësat

Gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kërkuan gojarisht që Gjyqi të zhvillojë një inspektim të vendit të krimit.

Gjyqi hedh poshtë këtë parashtrësë duke marr parasysh faktet se mjaft prova ekzistojnë në dosjen e çështjes që reflektojnë vendin engjarjes ditën kritike, meqë fotografitë e kallëzimit penal janë marr në vendin engjarjes pasi që ka ndodhë ngjarja dhe poashtu skica e detajuar e vendit të ngjarjes janë siguruar.

6. Përgjegjësia Penale


Në pajtim të Nenit 12 (2) të KPK-së *“Person i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar apo për t’i kontrolluar veprimet e mosveprimet e tij ka qenë dukshëm e zvogëluar për shkak të e cekura në paragrafin 1 të këtij neni”*.

Më 12 Prill 2011, **dëshmitari ekspert**, Doctor Fahri Drevinja dha detaje lidhur me personalitetin e të akuzuarit që është diagnostifikuar si person me veti të çregullimit të tipit asocial me kodin F60.2 DSM IV. Dëshmitari ekspert mbeti pranë konkludimit të raportit mjeksor të datës 01.03.2011, duke thënë se në bazë të vetive të personalitetit të të akuzuarit, karakteri i veprës penale si dhe dinamika e veprës penale *“përgjegjësia e tij është e zvogëluar por jo në nivel qenësor”*

Nga raporti mjeksor, të konfirmuar në debatin e mbajtur në Gjyq më 12 Prill 2011, Gjyqi e konstaton se Mexhit Beqiri është penalisht përgjegjës për veprën e kryer penale, edhe pse përgjegjësia e tij ishte e zvogëluar, por **jo thelbësisht**.

F. Përcaktimi i Dënimit

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjyqi duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe faktorët rëndues, në pajtim me Nenin 64, Paragrafin (1) të KPK-së.



Sa i përket Pikës një të vrasjes së rëndë, Gjyqi e konsideron si rrethana rënduese këmbëngulësinë e veprimet penal, përkundër intervenimit të dëshmitarit Musa Beqiri, i cili ka bërë përpjekje të ndalë të pandehurin; akumulimi i krimeve brenda një periudhe të shkurtë kohore (vrasje, përdorim i armës me kërcënim). Kurse si rrethanë lehtësuese, Gjyqi e konsideron mospërkryerjen e funksionimit mendor të të pandehurit dhe karakterine tij asocial.

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri pranoi fajësinë lidhur me veprën Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve. Gjyqi e konsideron si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri mbante revole vazhdimisht (vërteton dëshminë gjë që poashtu është pranuar nga vet i pandehuri) dhe poashtu faktin se revolva ishte gati të përdorej dhe madje të rimbushet duke i falënderuar çasjes së një karikatore shtesë me plumba.

Sa i përket Pikës tre, Gjyqi e ka pranuar kërkesën e rikualifikimit nga ana e Prokurorit. Gjyqi ka marr si rrethanë lehtësuese faktin se kanosja nuk ka qenë këmbëngulëse dhe ka pushuar pasi viktima Musa Beqiri pushoi të rezistojë të pandehurin.


Për veprën penale të **Vrasjes së Rëndë**, sipas Nenit 147, paragrafit (5) të KPK-së, ligji parasheh një dënim penal të së paku 10 vjetësh burgim.

Për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së, ligji parasheh një dënim me gjobë deri në 7500 Euro dhe dënim me burg nga një deri në tetë vjet.

Për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së, ligji parasheh një gjobë soe brugim deri në dy vjet.

Mexhit Beqiri dënohet

- Me gjashtëmbëdhjetë /16/ vjet burgim për veprën penale **Vrasje e Rëndë**, nga Neni 147, pika 5 e KPK-së (Pika I);
- Me tre /3/ vjet burgim për veprën penale **Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së (Pika II);
- Me dy /2/ vjet burgim për veprën penale **Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së (Pika III).



Mexhit Beqiri ka kryer tri vepra penale. Në pajtim me rregullat e kalkulimit të dënimit të komplikuar, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individual, por jo i lartë aq sa shuma e përshkruar e dënimeve. Trupi Gjykses shqiptoi dënim tetëmbëdhjetë /18/ vjet burgim si dënim unik në pajtim të Nenit 71 Paragrafit (1) dhe (2) Pikës 1 të KPK_së.

I akuzuari ka qenë në paraburgim që nga 3 Maji 2010. Kjo periudhë kohore do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg në pajtim të Nenit 73, Paragrafit (1) të KPK-së.

G. Konfiskimi

Në pajtim me Nenin 60 paragrafit (1) dhe Nenit 328 Paragrafit (5) të KPK-së, Gjyqi urdhëron konfiskimin e revoles së sekuestruar ZASTAVA, e kalibrit 9 mm, me numër serik 40074.

H. Shpenzimet

Meqë Gjyqi e shpalli të pandehurin Mexhit Beqiri fajtor për **Vrasje të Rëndë**, nga Neni 147, pika 5 e KPK-së; të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (2) të KPK-së; **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armëve** sipas Nenit 328, paragrafit (1) të KPK-së, në pajtim me Nenin 102 paragrafi (2) të KPPK-së, Mexhit Beqiri do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale lidhur me këto vepra penale, em përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

Gjykata e Qarkut të Mitrovicës

P. No. 40/2010

E përpiluar në anglishte, gjuhë e autorizuar

Gjyqtare Kryesuese
Caroline Charpentier

Anëtar të Trupit Gjykses
Nikolay Entchev

Anëtar të Trupit Gjykses
Dariusz Sielicki

Këshilla Juridike:

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë më shkrim kundër këtij Aktgjykiminë Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës brenda 15 ditësh nga data e dorëzimit të kpjes së Aktgjykimimit.

